



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:232106
Datë: 12.07.2023
Numri i dokumentit: 04479406

C – IV. – 15 – 0248

Paditësja:

Z A nga fshati P i Komunës së Parteshit.

Kundër:

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. "Driton Hoxha", nr.55, Lagjja, "Lakrishtë", Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me **dt.12.07.2023**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses, Z A nga fshati P i Komunës së Parteshit dhe Vendimi, GJI066-0023 i dt.18.02.2015 i Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), **VËRTETOHET si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Me 17 mars 2015, paditësja, përmes dërgimit me postë, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), ka parashtruar ankesë kundër Vendimit, GJI066-0023 të dt.18.02.2015 (Nr.22113 të dt.23.02.2015) të Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për Ndërmarrjen Shoqërore, NSh "Zarija Bujiq" me seli në Gjilan në likuidim e me të cilin, paditëses, i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e saj e me të cilën ka kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara (përfshirë edhe 3 pagat e pa paguara) për periudhën e pa përcaktuar në shumën prej 19,950.00 € nga NSh "Zarija Bujiq" me seli në Gjilan (në likuidim) e duke u bazuar në nenin 40.1 pika 6 e Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe cili parasheh që tri pagat e pa paguara janë kërkesa preferenciale dhe se të tilla kanë prioritet. Mirëpo ky ligj nuk ia pranon të gjithë të punësuarve të drejtën në tri paga por më tepër i ndan prioritetin për tri paga të cilat eventualisht kanë mbetur të pa paguara nga tërësia e pagave për të cilat vërtetohet se NSh-ja nuk ka mundur t'i paguaj të punësuarit e më gjerësisht si në këtë vendim të AL-së.

Paditësja në këtë ankesë ka theksuar se së pari ka vërejtje në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sepse nuk e ka njoftuar me shkrim për privatizimin e ndërmarrjes së saj e në të cilën ajo ka qenë punësuar që nga dt.04.12.1989 e deri në vitin 2014 sikurse edhe punëtorët e tjerë, se nga dokumentacioni që kemi gjetur - janë lista e pagave në të cilën qartazi mund të shikohet se sa ka qenë paga (edhe pse ashtu mund të thuhet) për orar të plotë të punës që e kemi kaluar në punë, si dhe ekziston fletorja e nënshkrimeve të punëtorëve të cilët kanë ardhur në punë e kur kjo të krahasohet me listat e pagave aty shihet qartë si ajo por edhe kolegët e saj, nuk ka pranuar disa muaj pagë, kërkon kompensimin e pagës prej viti 1999 - 2011, se më vonë nga viti 2011, në Kooperativën Bujqësore, ka ardhur sipas nevojës sikurse edhe kolegët e tjerë, se nuk sheh arsyen se pse vetëm ajo është refuzuar kur të gjithë kemi qenë bashkë (apo ka diçka që ajo nuk e din), se sipas vendimit qëndron se ajo nuk është në listën e punëtorëve aktiv prej viti 2000 – 2014 dhe se kjo nuk është e vërtetë sepse e tërë arkiva e librave të cilën AKP-ja e ka marrë, ajo vet e ka rregulluar, e më gjerësisht si në këtë ankesë/padi.

Pala paditëse parashtresën e ka titulluar si “*ankesë*” mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Paditësja, ankesës/padisë së saj, ia ka bashkangjitur, provat siç janë: kopja e librezës së punës nr.42315/88, kopja e Vendimit, Nr.16/90 të dt.09.01.1990 të NSh, “Zarija Bujiq” me seli në Gjilan për themelimin e marrëdhënies së punës së paditëses, kopja e Vendimit, Nr.72/90 të dt.15.11.1990 të NSh, “Zarija Bujiq” me seli në Gjilan për caktimin e përhershëm në vendin e punës së paditëses, dhe kopja e ID-së së saj por jo edhe Vendimin e AL-së, GJI023-0018 të dt.18.02.2015.

Me dt.29.09.2017, e paditura, AKP me seli në Prishtinë, ka parashtruar mbrojtje ndaj ankesës së paditëses të parashtruar kundër Vendimit të AL-së, GJI023-0018 të dt.18.02.2015, e duke pretenduar se Vendimin e vet, AL-ja, e ka bazuar në provat: se sipas arkivës së NSH-së, parashtruesja e kërkesës nuk ka qenë punëtoare aktive në NSh, që nga viti 2011, se neni 40.1.6.1 i të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L-034 për AKP-në, nuk e pranon automatikisht të drejtën e punëtorëve për tri paga të pa paguara, por vetëm i jep prioritet tri pagave të cilat kanë mbetur të pa paguara nga tërësia e të gjitha pagave të cilat ndërmarrja nuk ua ka paguar punëtorëve dhe në bazë të nenit 36 2.1 të Shtojcës së Ligjit, nr.04/L – 034 dhe neni 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar (i publikuar në Gazetën Zyrtare, Nr.53 të viti 1976, kërkesa është refuzuar si e pavlefshme, se paditësja, kërkesën e saj, e ka bërë me dt.19.03.2015 kundër Vendimit në të cilin ka vënë në pah se ka të drejtë në shumën e kërkuar, dhe kjo kërkesë është për periudhën 1999 - 2011, dhe ka theksuar se ka qenë e diskriminuar, se paditësja nuk e ka saktësuar se cili neni i Ligjit, Nr.04/L – 034, është shkelur nga AL-ja dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 70.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L-034 për AKP-në, se e drejta për të paraqitur padi kundër NSH-së, ka qenë e garantuar me nenin 4 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.2002/13, pra në momentin kur paditësja, nuk ka filluar të mos marrë paga nga NSH-ja, se sipas nenin 36 2.1 të Shtojcës së Ligjit, nr.04/L – 034 parashihet kufizimet kohore për bërjen e kërkesës për pagat e pa paguara, se viti 1999, ka qenë koha kur paditësja e ka fituar të drejtën e saj procedurale që të bëjë kërkesë pranë NSH-së pranë gjykatave të atëhershme, se ajo nuk ka vepruar në këtë mënyrë dhe se për shkak të kësaj paditëses, i është parashkruar e drejta më vonë, pra në vitin 2002, se sipas nenit 36 2.1 të Shtojcës së Ligjit, nr.04/L – 034, parashihet parashkrimin e një kërkesë, sa i përket pagave të cilat i pretendon padisja se nuk i janë paguar, se e drejta për të kërkuar paga të pa paguara parashkruhet tre vjet nga koha kur punëdhënësi nuk ka përmbushur detyrimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës, andaj duke u bazuar në nenin 36 par.2 pika 1 e Shtojcës së Ligjit, nr.04/L-034 dhe neni 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, kërkesa e paditëses, është refuzuar si e parashkruar, se disa herë nga DhPGJS e cila trajton këto lloj pretendimesh e zbatimi i saktë i

nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar është konfirmuar më shumë se një rast nga DhPGJS, (C – IV – 0960,C – IV. – 13 – 1711, C – IV - 2237, dhe C – IV. - 13 – 1602 etj).Tutje, e paditura, pretendon se parashtruesja, si në procedurën e likuidimit ashtu edhe në ankesën e saj, të drejtën e saj nuk e ka mbështetur me prova dhe fakte, se mos parashtrimi me kohë i paditëses për kërkesën për realizimin e të drejtës për pagat e pa paguara, e ka sjell parashkrimin e saj e për më tepër e paditura, pretendon se kërkesa është e parashkruar në përputhje me nenin 36 par.2 pika 1 të Shtojcës së Ligjit, nr.04/L - 034 dhe nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (LPB), pra se afati i parashkrimit për të bërë një kërkesë të tillë është 3 vjeçar, se duhet të bëhet dallimi në mes afatit për dorëzimin e kërkesave nga neni 7.2.6.2 të Shtojcës së Ligjit, nr.04/L-034 dhe afatit të parashkrimit të kërkesës sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (LPB), që ka të bëjë afatin 3 vjeçar për parashtrimin e një kërkesë nga marrëdhënia e punës dhe se kësaj mbrojtjeje, e paditura, ia ka bashkangjitur, Vendimin e AL-së, GJI066-0023 të dt.18.02.2015 dhe i ka propozuar gjykatës që t'a refuzoj si të pa bazuar të ankesën e paditëses dhe t'a vërtetoj Vendimin e Autoritetit të likuidimit në pajtim me nenin 70.4 të Ligjit nr.04/L – 033 e më gjerësisht si në këtë Mbrojtje.

Paditësja, pas pranimit të Mbrojtjes së të paditurës, me dt.05.10.2017 por dhe me dt.14.04.2023 dhe atë sipas Urdhrit të kësaj gjykate, C – IV. – 15 – 29.03.2023 pas kalimit të afati të dhënë por edhe deri më tani nuk ka prova se ka paraqitur përgjigje në këtë mbrojtje të të paditurës.

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 71 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji .

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban padia/ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata marr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata vlerësoj se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses, duhet të refuzohet si e pabazuar.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditësit.

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqës, dhe ka konstatuar, se me vendimin gjegjës të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, N.Sh “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan, me dt.24.02.2014, ka hyrë në procedurën e likuidimit derisa pala paditëse pranë Autoritetit të Likuidimit (AL), me dt.14.04.2014, pra brenda afatit ligjor, ka parashtruar kërkesë për kompensimin e pagave të pa paguara (përshirë edhe tri paga të pa paguara) për periudhën e pa përcaktuar në shumën prej 19.950.00 € nga N.Sh “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan (në likuidim) dhe se Autoriteti i Likuidimit pasi që ka bërë vlerësimin e kërkesës së parashtruar nga paditësi dhe se me Vendimin, GJI023-0018 të dt.18.02.2015, kërkesën në fjalë të paditësit, ia ka refuzuar si e pa vlefshme derisa paditësi, pas pranimit të këtij Vendimi në procedurën e likuidimit (nëse vendimi nga paditësi, është pranuar me dt.23.03.2015, data e pranimit nuk llogaritet në afatin gjegjës), ankesën kundër Vendimit, GJI023-0018 të dt.18.02.2015 të AL-së, pranë DhGJSK-së, e ka paraqitur përmes dërgimit me postë me dt.17.03.2015, pra brenda afatit ligjor prej 30 ditëve dhe se padisë/ankesës së tij, paditësja, edhe pse ia ka bashkangjitur një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi pra Vendimin, GJI023-0018 të dt.18.02.2015 të Autoritetit të Likuidimit për Ndërmarrjen Shoqërore, N.Sh “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan (në likuidim).

Në nenin 36 Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) që flet për pranueshmërinë e një kërkesë/ankese, aty thuhet se: *''...Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse: Dhoma e Posaçme ka juridiksion në bazë të nenit 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme; paditësi ka të drejtë të nisë procedurat në mbështetje të paragrafit 1 të nenit 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme;...''*.

Në nenin 74 Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) që flet për shqyrtimin e vendimeve të Autoritetit për likuidim aty thuhet se: *....Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendimi i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit...''* derisa në nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, parashihet se: *''Kreditori i prekur ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit nga ana e Autoritetit të Likuidimit që të vendos për kërkesën e tij dhe mos kërkiti i tillë në kohë nga ana e kreditorit do ta pamundësojë atë në kundërshtimi i mëtejme i vendimit të Autoritetit të Likuidimit''*. Gjykata, vlerëson se padia e paditësit i plotëson kriteret e pranueshmërisë nga dispozitat e lartëcekura ligjore por edhe se e njëjta padia, pranë e DhPGJSK-së është bërë brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve pas ditës së pranimit të Vendimit të kontestuar të AL-së, GJI023-0018 të dt.18.02.2015 për N.Sh “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan e me të cilin paditëses, i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara (përshirë edhe tri paga të pa paguara) për periudhën e pa përcaktuar në shumën prej 19.950.00 €, i plotëson kriteret e pranueshmërisë sepse është paraqitur me dt.17.03.2015, pra është paraqitur brenda afati prej 30 ditëve pas ditës së pranimit të këtij Vendimi (me dt.23.02.2015 apo pas kësaj date).

Faktet kontestuese dhe jo kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata vlerëson se në mes palëve ndërgjyqëse, nuk është kontestuese se paditësi me të paditurën, Ndërmarrjen Shoqërore (N.Sh), “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan (në likuidim), kanë pasur raport të marrëdhënies së punës dhe se paditësja te e paditura, si ish punëdhënësi i tij, ka qenë i punësuar punuar që nga viti 1990 por kontestuese mbetet çështja e bazës ligjore që paditësja, a ka të drejtë që të kërkojë nga e paditura, Ndërmarrja Shoqërore, NSh-ja, kompensimin e pagave të pa paguara (përshirë edhe tri paga të pa paguara) për periudhën e pa përcaktuar në shumën prej 19.950.00 € por edhe se këtë kërkesë a e ka bërë brenda afatit të paraparë ligjor për realizimin e tyre të detyrueshëm, pra përmes rrugës gjyqësore.

Paditësja, në procedurën e likuidimit, kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara (përshirë edhe tri paga të pa paguara) për periudhën e pa përcaktuar në shumën prej 19.950.00 € e ka bërë brenda afatit ligjor mirëpo kërkesa e saj është refuzuar si e pa vlefshme me Vendimin e Autoritetit të likuidimit të AKP-së, GJI066-0023 të dt.18.02.2015 dhe atë për shkak të parashkrimit të kërkesës kurse edhe ankesën kundër këtij vendimi, pranë Dhomës së Posaçme, e ka bërë brenda afati të paraparë ligjor për ushtrimin e saj.

Në nenin 6 të Ligjit Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), që flet për fushëveprimin e kompetencave administrative të Agjencisë, aty thuhet se: *''Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2. Agjencia i konsideron të arsyeshme dhe të duhura për ruajtjen ose rritjen e vlerës, shanseve për sukses ose qeverisjes së ndërmarrjes ...''*.

Ndërsa në nenin 14.1 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 (si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës), ka paraparë se: *“Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b)*

punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës” derisa neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) derisa në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit), parashihet se : “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit ...” . Po ashtu në nenin 76 të Ligjit të Punës, që flet për Largimet kolektive nga puna, aty parashihet se : “Ndërprerja e Kontratës së Punës sipas nën-paragrafit 1.1. të paragrafit 1 të nenit 70, të këtij ligji ku përfshihen së paku 10% të të punësuarave por jo me pak se njëzet (20) të punësuar, të larguar brenda intervalit kohor prej gjashtë (6) muajsh, konsiderohet si largim kolektiv nga puna;...”.

Gjykata për rastin në fjalë merr për bazë faktin se paditësja, nuk ka ofruar punë apo shërbim si e punësuar tek (NSH), “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan për periudhën kohore për të cilat përmes ankesës/padisë së saj i ka kërkuar pagat e pa paguara (përfshirë edhe tri pagat e pa paguara) e që të kishte të drejtë në këtë kërkesë kurse lidhur me afatin ligjor për të paraqitur me kohë një kërkesë të tillë, kjo gjykatë vitin 2002, e mori si datë e fillimit të rrjedhjes së afatit të parashkrimit kur parashtruesja e ankesës, që nga viti 1999, nuk ka përfituar të ardhurat personale të pretenduara nga NSH “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan (në likuidim) si e paditur dhe se në bazë të dispozitave së mësipërme ligjore, kërkesa nga ana e paditëses, do të duhej të parashtrohej pranë ndonjë gjykate apo autoriteti kompetent brenda 3 (tre) vjetëve nga momenti kur parashtruesja - paditësja, e kishte fituar të drejtën për të dorëzuar kërkesën për kompensim për pagat e pa paguara dhe se sipas vlerësimit të gjykate, kërkesa e parashtrueses së ankesës/padisë lidhur me kompensimin e pagave të papaguara , është e parashkruar me kalimin e afatit prej 3 viteve, ndërsa kërkesa e saj është parashtruar fillimisht në Autoritetin e Likuidimit me dt.14.04.2014 kurse në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGKSK), është parashtruar ankesë me dt.17 mars 2015 dhe atë kundër Vendimit të AL-së, GJI066-0023 të dt.18.02.2015 për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan (në likuidim) e me të cilin, paditëses, i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim për pagat e pa paguara për periudhën e lartëcekur kohore.

Gjykata vëren se kërkesa e parashtruar, është bërë jashtë afatit të paraparë ligjor për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara (përfshirë edhe tri pagat e pa paguara) nga NSH-ja në fjalë, si palë e paditur pasi që paditësja, nuk ka arritur që të bind gjykatën se ka iniciuar procedurën gjyqësore duke ushtruar padi për kompensim nga data kur ka filluar të mos merr të ardhura nga Ndërmarrja në të cilën ka punuar dhe se gjykatat e rregullta të Kosovës, kanë në dispozicion arkivat për lëndën aktive të iniciuara nga palët para vitit 1999 dhe me kërkesë të palës nxjerrin parashtrësia për të dëshmuar iniciimin e procedurave gjyqësore.

Në bazë të nenit 31 par. 1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përcaktohet se: *“Palët, në parashtrësia e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës”* kurse në nenin 36 par.2 pika 1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në, parashihet se *“... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”* derisa në bazë të nenit 608 të Ligjit mbi Punën e Bashkuar (I publikuar në Gazetën Zyrtare nr.53 të vitit 1976) dhe si ligj i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/24 mbi Ligjin në Fuqi në Kosovë, parashihet se: *“Pagesa e shumëve të pagës apo rrogës, ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet”* e për më tepër edhe në nenin 137 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i vitit 1978 gjithashtu, parashihet afati i njëjtë kohor për parashkrimin e të gjitha kërkesave me para si rezultat i marrëdhënies së punës.

Ndërsa në nenin 40 par.1 pika 6.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në që flet për prioritetet e kërkesave dhe interesave, aty thuhet se : *Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... 1.6. kërkesat preferenciale të punonjësve në renditjen si në vijim: 47 1.6.1. kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person; apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në’’. Në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës , parashihet se: “Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore” derisa sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”.*

Gjykata vëren se paditësja, nuk e ka argumentuar me prova gjegjëse, se ka ofruar punë apo shërbim për të paditurën, NSH, “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan (për periudhën e specifikuar përmes ankesës/padisë së saj) 1999 - 2011) derisa kërkesa e parashtruar nga paditësja, nuk është bërë brenda afatit të paraparë ligjor për të kërkuar kompensimin në emër të pagave të pa paguara (përfshirë edhe 3 pagat e pa paguara) për periudhën e pa përcaktuar në shumën prej 19,950.00 € nga NSH, “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan (në likuidim), si palë e paditur pasi që paditësja, nuk ka arritur që të bind gjykatën se me kohë e ka kërkuar realizimin e detyrueshëm të kërkesës së saj pra nga viti 1999, kur ka filluar të mos merr të ardhura nga Ndërmarrja në të cilën ka punuar edhe pse padisë së saj, ia ka bashkangjitur provat gjegjëse siç janë : kopjen e librezës së punës nr.42315/88, kopjen e Vendimit, Nr.16/90 të dt.09.01.1990 të NSH “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan për themelimin e marrëdhënies së punës së paditëses, dhe kopjen e Vendimit, Nr.72/90 të dt.15.11.1990 të NSH “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan për caktimin e përhershëm në vendin e punës së paditëses, e të cilat prova nuk që e provojnë pretendimin e saj, se paditëses, Z A nga fshati P i Komunës së Parteshit, i takon kompensimi në emër të pagave të pa paguara në shumën prej 12,836.44 € për periudhën nga viti 2004 deri në vitin 2013 por edhe se kjo kërkesë, është pa bazuar sepse është bërë edhe jashtë afatit ligjor për të kërkuar realizimin e detyrueshëm të tyre. Pra, përkitazi me çështjen e pretendimit të të paditurës për parashkrimin e kërkesës së paditëses për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara për shkak të përfundimit të punësimit te NSH-ja në fjalë, gjykata vlerëson se një pretendim i tillë i të paditurës, është i bazuar sepse paditësja, për gjykatën nuk ka ofruar prova gjegjëse në mbështetje të kërkesës së saj edhe pse asaj i është dhënë mundësia për të paraqitur Përgjigjeje në Mbrojtjen e të paditurës dhesë me gjendjen e tillë të shkresave të lëndës, kërkesën e paditëses, e bënë të pabazuar por edhe se e njëjta kërkesë, është bërë edhe jashtë afatit ligjor për të kërkuar realizimin e tyre përmes rrugës gjyqësore.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës.

Gjykata vlerëson se qëndron pretendimi i të paditurës, se gjetja e AL-së se sipas arkivës së NSH-së, parashtruesja e kërkesës – paditësja, nuk ka qenë punëtore aktive në NSH, që nga viti 2011, se paditësja për gjykatën, nuk ka ofruar prove bindëse se ka bërë kërkesë për pagat e pa paguara në gjykatën kompetente të atëhershme sepse që nga viti 1999, ka qenë koha kur paditësja e ka fituar të drejtën e saj procedurale që të bëjë kërkesë pranë NSH-së, pra se ajo nuk ka vepruar në këtë mënyrë dhe se për shkak të kësaj paditëses, i është parashkruar e drejta më vonë, pra në vitin 2002, edhe përkundër asaj se ankesë /padisë së saj ia ka bashkangjitur provat gjegjëse siç janë : librezat e punës nr.42315/88, Vendimi, Nr.16/90 i dt.09.01.1990 të NSH “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan për themelimin e marrëdhënies së punës, Vendimi, Nr.72/90 i dt.15.11.1990 të

NSh “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan për caktimin e përhershëm në vendin e punës së paditëses, dhe se librezat e punës e paditëses, nuk figurojnë të jetë e mbyllur derisa të Ndërmarrja Shoqërore, NSh “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan (në likuidim), paditësja që nga dt.04.12.1989, ka themeluar marrëdhënien e punës megjithatë edhe përkundër këtyre provave, paditësja nuk ka arritur që t’a bind gjykatën, se ajo ka kryer punë apo shërbim të e paditura, NSh “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan pas viti 1989 si dhe se të njëjtës, i takon kompensimi në emër të pagave të pa paguara (përfshirë edhe 3 pagat e pa paguara) për periudhën e pa përcaktuar në shumën prej 19,950.00 € nga NSh “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan (në likuidim), si dhe se kërkesën e saj e ka bërë pas kalimit të afatit të paraparë ligjor prej 3 (tre) vjetëve për të kërkuar realizimin e saj përmes rrugës gjyqësore, andaj gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore, kërkesëpadia e paditëses, është e pa bazuar, dhe se Vendimin e AL-së, GJI066-0023 të dt.18.02.2015 për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh) “Zarija Bujiq“ me seli në Gjilan (në likuidim), duhet t’a vërtetoj si të drejtë dhe të ligjshme.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK).

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par.5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2022:232106, 12.07.2023

**Gjykatësi,
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda 15 (pesë mbëdhjetë) ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.